

KONKURS FOTOGRAFIE

<p>Kush mund të aplikojë</p>	<p>Studentët e Akademisë së Arteve dhe Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”, si dhe të rinjtë nga mosha 16 – 30 vjeç të apasionuar pas fotografisë.</p>
<p>Çmimet e fituesve</p>	<p>Tre çmime prej të cilave do të kemi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendi i 1 – 90,000 lekë 2. Vendi i 2 – 60,000 lekë 3. Vendi i 3 – 40,000 lekë <p>Gjithashtu, fituesit e konkursit do të kenë mundësi të lidhin një kontratë afatgjatë me projektin “Aftësi për Punë” për sa i përket shërbimit të fotografisë.</p>
<p>Temat e konkursit (Zgjidhni një prej tyre)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lumturia pas pandemisë – Kapni momentet e bukura nga përditshmëria juaj, pas pandemisë. 2. Jeta para dhe pas Covid-19 – Një realitet dyngjyrësh. 3. Kapur për dore – Një temë e cila ka për qëllim demonstrimin e rëndësisë dhe dashurisë për gjyshërit. 4. Të rinjtë e viteve 2000 dhe të rinjtë e viteve 2020 – Paralelizëm gjeneratash. Jeni të ftuar të prezantoni paralelizma të realitetit të të rinjve në vitet 2000 dhe 2020. 5. Jeta në smartphone – Këndvështrime me dy ngjyra. Qëllimi: Rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve për përdorimin e telefonit më shumë se normalja. 6. Vizito Shqipërinë! Qëllimi: Promovimi i destinacioneve shqiptare. 7. Fast Fashion – Koncepti “Fast Fashion” dhe si po ndikon në ndotjen globale. Qëllimi: Riciklimi i rrobave, pasi shkaktojnë ndotje të madhe.

	8. Nostalgji dhe kulturë – Prezantim i punimeve tradicionale në çdo kënd të qytetit. Qëllimi: Promovim i kulturës.
Rregullat e aplikimit	<p>Për të marrë pjesë në konkurs, duhen ndjekur këto rregulla:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fotot duhet të jenë origjinale. 2. Fotot duhet t'i përmbahen temës së konkursit. 3. Fotot duhet të shpërndahen në rrjetet sociale, të paktën Instagram, dhe të bëjnë tag projektin “Aftësi për Punë” (skills_for_jobs). 5. Profili i përdoruesit duhet të jetë publik dhe duhet të përdorë hashtag #aftesiperpune. 6. Në vlerësim do të ketë 50% peshë pëlqimi nga audienca online.
Data e shpalljes	28 Shtator 2021
Afati i aplikimit	25 tetor 2021
Shpallja e fituesve	Fituesit janë parashikuar të shpallen në datën 1 Nëntor 2021.
Dorëzimi i aplikimit	Punët duhet të dërgohen elektronikisht në adresën al.info@swisscontact.org
Pyetje/përgjigje	Të interesuarit për të aplikuar mund të dërgojnë pyetje në adresën al.info@swisscontact.org

Informacion i Përgjithshëm

Swisscontact është një fondacion i pavarur zviceran që promovon zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor. Objektivi i Swisscontact është krijimi i mundësive për të larguar nga varfëria njerëzit e vendeve në zhvillim përmes një zhvillimi ekonomik me bazë të gjerë. Përmes projekteve të ndryshme, Swisscontact lehtëson aksesin në programe të zhvillimit të aftësive, nxit sipërmarrjen konkurruese, krijon akses për shërbimet lokale financiare dhe promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve.

“Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. Ky projekt është pjesë e Sferës së Zhvillimit Ekonomik të Strategjisë së Bashkëpunimit Zviceran për Shqipërinë (2018-2021), me fokus të veçantë tek promovimi i mundësive për punësim dhe zhvillimin e aftësive.

Projekti fokusohet në katër sektorë me potencial për zhvillim dhe krijim të vendeve të reja të punës: Hoteleri-Turizmi, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Tekstili dhe Ndërtimi (me fokus tek teknikat moderne të ndërtimit dhe kursimi i energjisë).


Projekti është në fazën e dytë, e cila nisi në muajin prill 2019 dhe do të vijojë deri në muajin qershor 2023. Në këtë fazë, projekti synon të mbështesë 10.000 nxënës (6.360 më shumë se sa në Fazën I) dhe 6.000 kursantë (1.500 më shumë se sa në Fazën I).

“Aftësi për Punë” (S4J) u projektua për të adresuar sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP), të tilla si: cilësia dhe statusi i ulët, financimi i pamjaftueshëm, orientimi i dobët nga tregu i punës dhe angazhimi i dobët i sektorit privat. Projekti i adreson këto sfida duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve kyç. Bazuar mbi këtë qasje, “Aftësi për Punë” mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në Shqipëri në drejtim të:

- Krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë,
- Diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore,
- Aplikimit të metodave novatore të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë,
- Realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit,
- Zhvillimit dhe fuqizimit të institucionit, përmes ndërtimit të mekanizmave për menaxhimin eficient.

Aftësimi nëpërmjet punës, përdorimi i teknologjisë në orën e mësimi, aplikimi i një ndërthurjeje midis të nxënësve të kombinuar dhe të individualizuar, përditësimi i programeve dhe trajnimeve sipas standardeve të industrisë dhe aplikimi i një mendësie biznesi në menaxhimin e institucioneve të AFP-së qëndrojnë në thelb të punës së projektit “Aftësi për Punë” (S4J).

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Në partneritet me:



Zbatuar nga:




Projekti mbështet dhjetë ofrues të AFP-së në Shqipëri: shkollën profesionale “Hamdi Bushati” në Shkodër, shkollën profesionale “Kolin Gjoka” në Lezhë, shkollën teknike-elektrike “Gjergj Canco” në Tiranë, Shkollën Teknike Ekonomike në Tiranë, shkollën profesionale “Ali Myftiu” dhe shkollën profesionale “Salih Çeka” në Elbasan, shkollën profesionale “Kristo Isak” në Berat, shkollën Tregtare, shkollën industriale “Pavarësia” dhe Qendrën e Formimit Profesional në Vlorë.

Qëllimi i konkursit

Në S4J ne praktikojmë komunikimin për zhvillim (C4D), duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit, nxitjen e dialogut dhe ndryshimin e mendësisë së audiencës sonë. Për këtë arsye, imazhi profesional, përfshirë edhe fotografitë, është një pjesë kyçe e strategjisë sonë të komunikimit.

Përmes këtij konkursi, projekti “Aftësi për Punë” dëshiron të identifikojë talente të reja në fotografi për një bashkëpunim të mundshëm afatgjatë. Apliko, fito dhe puno me ne! 😊

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:

